

Të dashur pjesëmarrëse dhe pjesëmarrës të pyetësorit AZR,

Ju përshëndesim nga faqet tona informuese. Instituti për Kërkime të Tregut të Punës dhe Profesioneve (IAB), në bashkëpunim me Qendrën Kërkimore të Zyrës Federale për Migracionin dhe Refugjatët (BAMF-FZ), po realizon një pyetësor një pyetësor online me emigrantë punëtorë që kanë ardhur së fundmi. Qëllimi është të mblidhen të dhëna mbi situatën e jetesës dhe atë profesionale të të anketuarve, si dhe mbi planet e tyre për qëndrim ose kthim.

Informacionet mbi përdorimin e të dhënave i gjeni në informacionet për *mbrojtjen e të dhënave për pyetësorin AZR*.

Për pyetje të mëtejshme, mund të kontaktoni hulumtuesit përkatës përmes emailit në: iab.projektfeg20@iab.de

FAQ – Pyetjet më të shpeshta

1. Cilat tema trajton pyetësori?

Pyetësori është pjesë e projektit kërkimor *Vlerësimi i ligjit dhe i rregullores për zhvillimin e mëtejshëm të emigrimit të fuqisë punëtore të kualifikuar*. Në këtë projekt analizohen reformat e ligjit "Për emigrimin e fuqisë punëtore të kualifikuar" (*Ligji dhe rregullorja për zhvillimin e mëtejshëm të emigrimit të fuqisë punëtore të kualifikuar*), të cilat kanë hyrë gradualisht në fuqi që nga 18 nëntori 2023. Në këtë kuadër në pyetësor po shqyrtohet se cilat janë sfidat ekzistuese në zbatimin administrativ të ligjit, veçanërisht nga këndvështrimi i personave që kanë emigruar. Gjithashtu analizohen më në detaje integrimi në tregun e punës i specialistëve dhe punëtorëve që sapo kanë emigruar, si dhe përvojat e tyre në Gjermani.

2. Kush mund të marrë pjesë në pyetësor? Përse jam i regjistruar?

Adresën tuaj e kemi marrë nga Regjistri Qendror i të Huajve (AZR), i cili administrohet nga Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët (BAMF). Ligji për AZR-në na mundëson, sipas nenit 24a, paragrafi 6, në kushte të caktuara, përpunimin e të dhënave personale për qëllime shkencore.

Do të anketohet një kampion përfaqësues i zgjedhur në mënyrë rastësore, ku emigrantët me leje qëndrimi për punësim në bazë të një përvojë profesionale praktike të zgjeruar (neni 19c, paragrafi 2 i Ligjit "Për qëndrimin në Gjermani" së bashku me nenin 6 të Rregullores për Punësimin) si dhe personat e pajisur me Kartën e Mundësive (sipas nenit 20a të ligjit "Për qëndrimin në Gjermani") do të kontaktohen në mënyrë gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, do të përfshihen në mënyrë disproporcionale në këtë kampion edhe personat me leje qëndrimi sipas nenit 16d të ligjit "Për qëndrimin në Gjermani" (masat e procesit të njohjes).

Ftesa për pjesëmarrje në pyetësor bëhet përmes një linku, i cili u dërgohet me postë personave që anketohen, në portalin online INGRESS, ku dhe do të zhvillohet pyetësori.

Fatkeqësisht, nuk është e mundur që persona të tjerë të interesuar, të cilët nuk kanë marrë ftesë, të marrin pjesë në studim.

3. Përse është e rëndësishme pjesëmarrja juaj?

Duke ndarë informacione për situatën e tyre të jetesës në pyetësorë, njerëzit u mundësojnë studiuesve shkencorë të identifikojnë dhe të kuptojnë më mirë nevojat dhe sfidat. Sa më shumë persona të marrin pjesë në pyetësorë të tillë shkencorë, aq më i saktë dhe më gjithëpërfshirës bëhet pasqyrimi i zhvillimit të jetës dhe punës së emigrantëve në Gjermani. Prandaj mbështetja juaj ka rëndësi të madhe. Përvojat tuaja dhe rekomandimet e bazuara që nxjerrim nga rezultatet u vijnë në ndihmë vendimmarrësve politikë. Kështu mund të identifikojmë potencialin për përmirësim të ligjit dhe të optimizojmë emigrimin e fuqisë punëtore të kualifikuar.

4. Si i ka siguruar Instituti për Kërkime të Tregut të Punës dhe Profesioneve të dhënat e mia të kontaktit?

Adresën tuaj e kemi marrë përmes Regjistrat Qendror të Huajve (AZR), i cili administrohet nga BAMF-i. Ligji për AZR-në na mundëson, sipas nenit 24a, paragrafi 6, në kushte të caktuara, përpunimin e të dhënave personale për qëllime shkencore. Ju mund ta kundërshtoni në çdo kohë transmetimin e të dhënave tuaja. Si dhënia e pëlqimit për transmetimin e të dhënave tuaja, ashtu edhe pjesëmarrja në pyetësor janë vullnetare. Me pjesëmarrjen tuaj, ju jepni një kontribut të rëndësishëm për përmirësimin e situatës së fuqisë punëtore të huaj të kualifikuar në Gjermani. Të dhënat tuaja përdoren ekskluzivisht për qëllime shkencore. Informacione të tjera për mbrojtjen e të dhënave i gjeni në *Deklaratën e Privatësisë*.

5. Kush është pjesëmarrës në projekt?

Ministria Federale e Punës dhe Çështjeve Sociale (BMAS) dhe Ministria Federale për Punët e Brendshme (BMI) kanë mandatuar vlerësimin shkencor të reformave të ligjit "Për emigrimin e fuqisë punëtore të kualifikuar" në përputhje me mandatin statutor të parashikuar. Vlerësimi kryhet në bashkëpunim ndërmjet Institutit për Kërkime të Tregut të Punës dhe Profesioneve (IAB) dhe Qendrës Kërkimore të Zyrës Federale për Migracionin dhe Refugjatët (BAMF-FZ).

BAMF-i është një autoritet federal në varësi të BMI-së dhe është qendra e kompetencës për azilin, migracionin dhe integrimin në Gjermani. Qendra kërkimore pranë kësaj zyre analizon lëvizjet emigruese drejt dhe nga Gjermania, shoqëron procesin e integrit të personave që kanë emigruar, si dhe kryen studime vlerësuese për programe dhe masa konkrete. Baza ligjore e kërkimit në BAMF është neni 75 nr. 4 dhe 4a i Ligjit për Qëndrimin (AufenthG). Informacione të mëtejshme për Qendrën Kërkimore të BAMF-it mund t'i gjeni në:

www.bamf.de/DE/Themen/Forschung/forschung-node

IAB-i është institucioni kërkimor i Agjencisë Federale për Punësim. Detyra kryesore e këtij institucioni është të këshillojë aktorët politikë në të gjitha nivelet bazuar në njohuritë shkencore. Baza ligjore për kërkimin dhe këshillimin nga IAB është neni 55 i Ligjit Social II (SGB II) dhe nenet 280 nr. 2, 282 të Ligjit Social III (SGB III) (SGB është Kodi Social). Informacione të mëtejshme për Institutin për Kërkime të Tregut të Punës dhe Profesioneve mund t'i gjeni në faqen e internetit:

www.iab.de

Portali online INGRESS menaxhohet nga Ingress GmbH, një ofrues shërbimi i IAB-it. Ingress GmbH e zbaton teknikisht pyetësorin përmes portalit të tij online dhe ua përcjell të dhënat e mbledhura në kuadër të pyetësorit studiuesve të IAB-it. Shërbimi është i siguruar në aspektin e

mbrojtjes së të dhënave përmes një marrëveshjeje për përpunimin e të dhënave sipas nenit 28 të DSGVO-së, ndërsa Ingress GmbH vepron ekskluzivisht sipas udhëzimeve të IAB-it.

6. Si financohet studimi?

Ministria Federale e Punës dhe Çështjeve Sociale (BMAS) mbikëqyr projektin në cilësinë e porositësit dhe financuesit. Roli i saj kufizohet në koordinimin e dizajnit të përgjithshëm kërkimor dhe në përdorimin strategjik të rezultateve. BMAS-i nuk ndërhyr në vendimet metodologjike të detajuara dhe në operimin e vazhdueshëm në terren. Ministria Federale e Punëve të Brendshme (BMI) është gjithashtu porositëse e projektit.

Agjencia Federale për Punësim (BA) është gjithashtu e përfshirë në projekt si financuese.

7. Sa kohë duhet të planifikoj për t'iu përgjigjur pyetjeve?

Koha që u nevojitet pjesëmarrësve për t'iu përgjigjur pyetjeve është e ndryshme, në varësi të përvojës. Zakonisht, plotësimi i një pyetësori zgjat mesatarisht rreth 20 minuta.

8. A mund ta ndërpres pyetësin dhe ta vazhdoj më vonë?

Po, mund ta ndërpritni përkohësisht pyetësin në çdo moment, për sa kohë që nuk e mbyllni shfletuesin. Për shkak se pyetësi është plotësisht anonim dhe përgjigjet tuaja nuk lidhen me të dhënat tuaja personale, nuk është e mundur ta vazhdoni pyetësin pasi të keni mbyllur shfletuesin.

9. Sa shpesh mund të marr pjesë në pyetësor?

Ju mund të merrni pjesë një herë në pyetësor.

10. Çfarë ndodh me të dhënat e mia? Si vlerësohen të dhënat e mia?

Të gjitha përgjigjet nga pyetësi online përpunohen në mënyrë kompjuterike. Më pas, përgjigjet e të gjithë personave të anketuar analizohen në mënyrë statistikore. Nga të dhënat e përgjithshme mund të llogariten, për shembull, përqindjet ose të kryhen analiza statistikore. Rezultatet raportohen në tabela dhe grafikë.

Në IAB ruhen të dhëna administrative rreth jush, të cilat përfshijnë të dhëna nga marrëdhëniet me klientin dhe raportimet nga punëdhënësit (p.sh. periudha punësimi dhe papunësi). Këto të dhëna administrative vihen në dispozicion të IAB-it në përputhje me bazën ligjore të nenit 282, paragrafët 5 dhe 6 të SGB III. Për studiuesit, përgjigjet tuaja në këtë pyetësor kanë një vlerë të veçantë nëse mund të lidhen me të dhënat administrative që IAB-i disponon rreth jush, pasi kjo përmirëson cilësinë dhe vlefshmërinë e rezultateve të kërkimit. Pëlqimi juaj lidhur me këtë është vullnetar dhe do t'ju kërkohet para nisjes së pyetësit konkret.

11. Si mbrohen të dhënat e mia?

Të dhënat tuaja nga pyetësorët përpunohen duke respektuar rregullat e rrepta të mbrojtjes së të dhënave dhe ruhen të ndara nga emri dhe adresa juaj. Përgjegjëse për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të këtij pyetësoni është Agjencia Federale për Punësim, e përfaqësuar nga bordi drejtues, Regensburger Str. 104, 90478 Nürnberg. Zbatimi teknik i pyetësonit bëhet nga kompania Ingress, si kontraktore e Institutit për Kërkime të Tregut të Punës dhe Profesioneve. Ingress vepron vetëm sipas udhëzimeve të Institutit për Kërkime të Tregut të Punës dhe Profesioneve dhe ka detyrim të ruajë konfidencialitet maksimal. Informacione më të detajuara për Ingress mund t'i gjeni në: www.ingress.de.

12. A do të përdoren të dhënat e mia edhe për qëllime të studimit të tregut ose për reklama?

Jo! Studimi realizohet vetëm për qëllime shkencore. Të dhënat nuk do të përcillen për qëllime studimi tregu apo reklamimi! Rezultatet e studimit do t'u vihen në dispozicion studiuesve të tjerë, politikëbërësve, administratës dhe publikut të interesuar. Nga rezultatet nuk do të jetë e mundur të identifikohen të dhëna individuale për personat pjesëmarrës.

13. Ku mund t'i shoh rezultatet e studimit?

Rezultatet e këtij pyetësoni do të prezantohen në vitet në vijim. Publikimi i raportit kryesor pritët të bëhet në pranverën e vitit 2028. Shpesh rezultatet e kërkimit raportohen edhe në media (gazeta të përditshme, lajme televizive).

14. Ku mund të drejtohem për pyetje ose komente?

Për pyetje të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni studiuesit e përfshirë, përmes email-it në adresën: iab.projektfeg20@iab.de.

15. Nuk dëshironi të merrni më mesazhe nga ne?

Na dërgoni një email në iab.projektfeg20@iab.de . Në rast të tillë, nuk do t'ju kontaktojmë sërish.